





SADULLA ZENDELI - DAJA  
**DËGJONI ZEMRËN TIME**  
POEZI, PËRJETIME DHE VLERËSIME

---

BOTIMET TOENA



SADULLA ZENDELI - DAJA

# DËGJONI ZEMRËN TIME

Poezi, përjetime dhe vlerësime

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Recensent: Viron Kona

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesje grafike: Elida Stafa

ISBN 978-9928-235-60-2

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**


Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)



Sadulla Zendeli - Daja





## PJESA E PARË



# Viti i Ri

Gëzuar festat e fundvitit!  
Gëzuar Vitin e Ri që vjen,  
Si një pëllumb i bardhë  
Në dritare po troket...  
Hape dritaren se Babadimri  
Në sofrën shqiptare ju pret.

Gotën lart për Vitin e Ri  
Për ju që gëzoni e pini,  
Të uritur asnjë mos lini!

*Suedi, 2017*

# Emrin e kam tetëdhjetë e dy

Pyes shpeshherë veten:

Shekujt apo jeta po më mashtrojnë?

Nocioni i kohës m'ka humbur, zanat më mbrojnë,

Jeta herë pas here më mundon,

Kohën ma merr e prapë s'e kthen,

Ky shekull thumbërisht më thumbon,

Dashuria ndaj vendit tim s'më mungon.

Punoj, krijoj, bisedoj, këndoj e qaj

Jetën në mërgim me djem e vajza e lashë.

Nipër, stërnipër, mbesa e stërmbesa,

Në dhé të huaj vuajnë, vuaj, si çdo i huaj.

I mbaj vuajtjet thellë në shpirt e në fjalë,

Zemrën time vetëm për ju e ruaj.

Njëzet e katër anëtarë të familjes i lashë,

Dritën e vendlindjes, oh, sa pak e pashë!

Vajmedet sa familje mërgimtare

N'dhé të huaj si unë kanë mbet'.

Mëmëdheu ende nuk na ka gjet',


As ne s'e njohim aq sa duhet,

Asimilimi është i egër, i sigurt,

Mbeta këtu, kështu si jam, i urtë.

Eci, këndoj, qaj e vajtoj,  
Askujt dhimbjet s'ia tregoj,  
Zanat e atdheut më mungojnë,  
Vitet shpirtin ma zптоjnë.  
Mos vallë fati i zi na ndëshkoi,  
Të tretemi përjetë në mërgim?  
Mos vallë Zoti na ka gjykuar,  
Apo armiku na ka mallkuar  
Që t'jetojmë n'vend të huaj?!

Ky shekull me thumba kuajsh,  
Këpucë të reja më ka dhënë,  
Rrebeshi i pafund në kurrizin tonë,



*Sadulla Zendeli - Daja,  
Tiranë, nëntor 2016.*

Dielli dritën e kursen, terrin e lëshon,  
Hëna me dritën e bekuar më orienton.

Meditoj e n'kalendar ditët i nënvizoj,  
Me gishta shumën e dhunës e pjesëtoj,  
Në dritë dua të ndriçojë ëndrra ime,  
Për ta parë të bashkuar,  
Atdheun, Shqipërinë time.

Diellin, hënën e yjet shumë i dua,  
Dielli edhe nën hije tanimë më djeg,  
Netëve hëna rrugën ma ndriçon,  
Shikoj qiellin e kthjellët,  
Vapën dua ta ndaloj...

Dua të kthehem n'vandin tim,  
Pa drojë të eci, me dëshirë,  
Kur vendi im të jetë i lirë,  
Me ëndrrat e mia e me ty,  
Mos u çudit, emrin e kam tetëdhjetë e dy.

*Suedi, ora 2:35*

# Shqetësimi im në mërgim

O bijtë dhe bijat e bekuara,  
Të këtij shekulli të trazuar,  
Që mjerisht hajninë e kanë kultivuar.  
Kush e mbolli korrupsionin,  
Vallë, kush e mbushi kamionin,  
Me djersën e gjakun e diasporës,  
Kush ia përpiu hakun Kosovës?  
Markat e mbledhura nga mërgimi,  
Gojëhequr për armë e luftë,  
Kush i vodhi pa mëshirë,  
Për pasurim e shpërdorim?  
Në shpirt hajnia u ka hyrë.  
Ç'shekull i shëmtuar,  
Na kthen prapa,  
Dëmton të lavdishmen histori.

# Sërmnova

Ashtu siç e pata lënë,  
Disa ndërtesa të reja,  
Bukurinë ia kishin dhënë.  
Rruga, e njëjtë si më parë,  
Lumi ndan Sërmnovën në dy anë.  
Zalli mbetur në gjendje të mjerueshme,  
Me plehra, hedhurina e mbeturina...  
Sëmundjet hynë brenda pragut t'shtëpisë,  
Dikur fëmijët e fshatit bënë banja,  
Peshqit i shoqëronin, s'kishte hajna.  
Lumi Zall më parë ishte i pastër si loti.  
Lumturi për fëmijët e fshatit qëmoti,  
Notonin e këndonin për lumin e moçëm.



*Sërmnova,  
fshati im.*



## E dashur, mos u mërzit!

Jam në rrugë duke ardhur,  
T'kam para syve si dielli i pranverës,  
O shpirti im, pritme sa të vij,  
Po fluturoj nga gëzimi,  
Të të takoj zemër, të adhuroj,  
Pa ty dot s'mund të jetoj...

Vrapoj e vrapoj, dua të të takoj,  
Me zërin e shpirtit tënd të bisedoj.  
Si dy bilbila do të fluturojmë,  
Në malet e kodrinat e Arbërisë,  
Pritme, se malli këputur m'ka,  
Ditë e natë në mendje t'kam...

Mos u mërzit, moj bukuri,  
Nisur jam, po vij vetëm për ty,  
Me një tufë lulësh e një gotë,  
Aty më prit, në portë,  
Me një gotë për mua e një për ty,  
Të dehemi me dashuri...

Eja, moj zanë, të të përqafoj,  
Ta ndiej dhe unë dashurinë  
Që ndaj teje e posedoj...

# As ti, as unë nuk do të vdesim!

Po të jem me ty, e ndiej  
Se kurrë nuk do vdesim.  
Luadhi, lëndina, zabeli,  
E sorkadhja në shkrepë,  
Me dashuri do na presin.  
Po të vdes unë para teje,  
Do jetë humbja e një beteje,  
Ku të kam, moj xhane me besë,  
Nuk desha të të lë pa shpresë!

Do të pres disa muaj,  
Të takohem me ty në urë,  
Prej teje s'do të ndahem kurrë.  
Gjithë jetën me ty kam kënduar,  
Kam qarë, qeshur dhe vallëzuar,  
Për mëmëdheun tonë të bekuar.

Nga kjo botë bashkërisht,  
Në botën tjetër pranë e pranë,  
Si dy zogj jetimë pa fole e pa vatan,  
Në vendlindjen e të parëve tanë...  
Nga kjo botë, për jetë të jetës jo më të ndarë.

Të folmen e gjuhës shqipe do dëgjojmë,  
Dasmat e vdekjet e Sërmmovës  
Do t'i shohim dhe kujtojmë...  
Lulet e pranverës do të lulëzojnë,  
Aromën e tyre do ta shijojmë...

Në lëndinat e Sërmmovës,  
Pranë dhe vetëm pranë...  
Do të bëhemi dhe gur graniti,  
N' vendlindjen tonë do këndojmë,  
Përjetë të jetës në varr të zi,  
Të përmalluar do qëndrojmë!

# Dilni të shihni se kush po vjen!

Vjen mërgimtari t'vizitojë mëmëdheun,  
Ecën ngadalë duke parë e duke qarë,  
Rrëke lotësh për Arbërinë e ndarë,  
Shtigje të mbyllura,  
Rrugën Arbëria e ka gabuar.  
Nuk qenke n'rrugë të mbarë...

Femrën shqiptare, osmanlinjtë e zezuan.  
Gjashtë shekuj ecën rrugëve të Arbërisë,  
Me perçe, shami e burka n'zi,  
Si në shkretëtirat e Arabisë...

Kthehuni kohës së Arbërisë sonë  
Kur dhe ne ishim botë.  
Këto mbulesa femrat iliriane,  
Si lëkurë të huaj n'trup i kanë.

Mos edukoni vajzën e djalin,  
Nipin, stërnipin, mbesën, stërmbesën,  
Me leckurinat e Turkmenistanit  
Dhe me ligësitë e reja t'Arabistanit.

E ç'na ka mbetur vallë tjetër,  
Veç të qajmë e të vajtojmë,  
Për dashurinë e vendit tonë,  
Lot, trishtim dhe pak shpresë!...

Zana ju shitoftë ju që shëmtoni  
Arbërinë tonë të bekuar,  
Vendin e shqiptarizmit  
Të lashtë e të kulturuar...

# O moj botë e dashur!

Mos më mashtro!  
Jam ai që ju më dini,  
Më keni parë, dëgjuar m'keni,  
Librat e mi i keni lexuar,  
Me ju kam punuar,  
Për ju kam shkruar,  
Për ju kam luftuar,  
Ju jeni engjëj t'bekuar.  
Ndaj meje jeni t'rezervuar...

Pash Perëndinë tregoni,  
Ndihem shumë i dëshpëruar!  
Kam drojë mos ju shqetësoj.  
Me gjithë zemër ju dua,  
Shpirtërisht shkruaj për ju!

Botës që herët diturinë ia blej,  
N'amshim drejtësinë do ta gjej.  
Dekoratat do të m'i dhurojnë,  
Nga gëzimi në gjoks do t'i var.  
Të faleminderit, moj botë e mbarë,  
Që e dekoron një mërgimtar!...

# Mos e fshih të vërtetën tënde!

*- kushtuar femrës shqiptare -*

Të vërtetën tënde bëje të dukshme,  
Pse e fsheh që mos të të shohë askush?!  
Hapi grushtet e duarve,  
Gishtërinjtë t'i kesh të lirë,  
Liria është në duart tuaja.

Me duart tuaja mbëlto tokën,  
Me farën e jetës sate.  
Prit me duar të lira  
Vera të lulëzojë.

Mbëlto kopshtin tënd  
Me lulet e pranverës.  
Kopshtin tënd le ta shohin  
Gjithë njerëzia...  
Ftoji ata t'i shijojnë  
Lulet e kopshtit tënd.

Ndërro të drejtën,  
Me njëri-tjetrin  
Mos e fshihni të vërtetën,  
Se kështu harroni veten,  
Po harrohesh dhe nga të tjerët.

## Ajo, vetëm ajo...

Ajo mund të ndriçonte  
Dhomën, fqinjët, qytetin,  
Malet e livadhet.  
E doja shumë, sa shumë...  
Kam lisin më të vjetër për ta parë,  
Kemi gjithçka për të parë...


Ajo do të mbetet  
Një rrënjë e ujitur.  
Shkollën e parë  
Të vajzave në Korçë e hapi.  
500 vjet na dhunuan shqiptarizmin,  
Ti nuk u ndale, o mësuese e parë,  
Shkronjat shqipe të arta i shkrove.  
Zogjtë cicërojnë e këndojnë  
Në atdheun e të parëve tanë.

Kur të shoh ty, vetëm ty,  
Gjithë botën e lirë sikur kam parë,  
Dhe fluturoj në qiellin e hapur,  
Kur vij sërish te ti,  
E di, më pret krahëhapur...



Dashuria jote rrënjë ka lëshuar në shpirtin tim.  
Jam nën hijen e rrënjëthellit lis,  
Që ti e mbëltove,  
E ujite, o e shtrenjta mësuese  
E shkollës së parë shqipe,  
Në Korçën e shqiptarisë u bërë!

Në pranverë lisi bukur gjelbëron.  
Zogjtë hareshëm cicërojnë e këndojnë.  
Unë vetëm për ty mendoj,  
Dëgjoj, meditoj, ëndërroj,  
Zërin tënd çdo çast e dëgjoj...



*Në kalanë  
e Petrelës,  
Tiranë,  
nëntor 2013.*

Germa shqipe nxënësve ua mësove.  
Këndoje këngët e malësisë.  
Me shkronjat e arta i ke qëndis’!  
Ku ndalojmë këngët që na i mësove,  
Me dashuri dhe lot në sy i këndojmë.  
Ty shumë të duam e kurrë s’të harrojmë!

*30 gusht 2016*

# Zoti komandant!

- Të lutem, prit pak, vetëm pak...  
- Kush... kush je ti, unë... unë?  
- Po, po, ju, zoti komandant,  
Më lejo t'ju pyes, e kam një hall:  
- U liruam nga gjyqi i Hagës.

- Në aeroportin e Prishtinës,  
Të pritnin shqiptarët krahëhapur.  
Populli i vuajtur të priti me padurim,  
Kryesia e Parlamentit nga mirësia  
Të kishin shtruar dhe të kuqin qilim.

Sapo zbrite nga aeroplani,  
Mikrofonin e kërkoje,  
Me dy fjalë shqiptarët informove:  
- O popull kosovar!  
Kosovën e çliruam mbarë!  
Unë do të jem i juaji kryetar!

Brohoritje, urraa... urraa... komandant, komandant!  
Do të bëhet presidenti i Kosovës sonë!

Populli u habit pa masë...  
Deri dje Kosova ishte e okupuar, e robëruar,

Këtë fat as dhe një diktator s’e kish menduar.  
Pika u rëntë këshilltarëve të tu,  
Pa pikë mëshire të paskan mashtruar!  
Si, pa votime, o komandant  
E shpall veten se do të bëhesh kryetar?!...  
Duro, o zotni, të të votojë populli shqiptar!

Barsoleta popullore thotë:  
“Vaj medet se ç’ra mbi milet,  
Komandanti thotë me gojën e vet!”.  
Çfarë kërkon ky ibret?!  
A e mbani mend ju motra e vëllezër shqiptarë,  
Vëllai i komandantit, luftëtar i UÇK-së,  
I theri gjashtëdhjetë dema për dasmën e vet!  
Kur gjaku rrugëve t’Kosovës ishte ende i patharë...

Shqiptarët të papunë,  
Në Kosovën e shkatërruar,  
Të vrarë, të dhunuar,  
Nga serbët e mallkuar,  
E ju të dashur politikanë,  
Të majtë e të djathtë, deputetë shqiptarë,  
Për ta asnjë fjalë nuk e thatë...

Opozita e pozita dy fjalë nuk i thanë,  
1480 euro e kishin pagën mujore.  
Mbi 6 muaj Kosova mbeti shkretë, pa Parlament!  
Zilitë tuaja dëmtojnë, parti kundër parti,  
Imazhin shqiptar n'botë e Dardani.

Hierarki e rëndë, ministra e zëvendës të tyre të punësuar,  
Para botës së qytetëruar,  
Qeverisjen e shqiptarëve dobësuan në Kosovë.

Kacafytje me njëri-tjetrin si ujë të uritur.  
Ku është humaniteti juaj,  
Dy ministra për një vend pune?!  
Ministër në Kosovë,  
Ministër në mërgatë,  
Shqiptarët vuajnë salltanetet tuaja?  
Pa shtëpi, pa punë, duke emigruar,  
Në botën e huaj t'pasiguruar...

O vëllezër e motra, kjo është marri  
Për ne që i kemi votuar...  
Parti mbi parti rrjetin kemi organizuar,  
Vetëm ta rrisim fondin  
E korruptuesve të organizuar.

Vajmedet për shqiptarët e korruptuar,  
Ju t'pandershëm nëpërkëmbni  
Të shumëvuajturin, popullin tuaj.

Të korruptuarit asnjë fjalë nuk thonë,  
Gjithmonë n'majë të gjuhës kanë:  
“Hajde, more, hajde... lëri këta gomarë!  
Ne kemi punën tonë, o jaranë!”.

Ata të korruptuarit e kanë blerë  
Tokën e Kosovës për një lek.  
Dëshmi të fshehura,  
Me dëshmitarë t'pacipë,  
Të lidhur me njëri-tjetrin,  
Ia bëni qejfin Serbisë vrastare:  
“Shqiptarët janë të pazotë  
Ta mbajnë shtetin e tyre”.

“Trimat e Kosovës”, këta avokatë,  
Gjokset rrahin se “mbrojnë Kosovën nënë”.  
Si lubi hapur ryshfetin gllabërojnë,  
Janë ngjitur si këpusha e zgjebes,  
Pinë si shushunja gjakun e shqiptarit.  
Ruajnë e mbrojnë delenxhinjtë

Mbarë dallaveraxhinjtë,  
Matrapazët që hanë djersën e shqiptarit,  
Ndajnë fitimet marramendëse me njëri-tjetrin.

Vajtori pi verë e raki dhe në çajtores,  
E klube seksi të fshehur.  
Brohoret me krenari:  
“Rroftë Kosova!  
Rroftë diaspora!  
Me mërgimtarët tanë!”.

Ububu, në zemrën time jam i plagosur,  
Çfarë zemre ka shqiptari ndaj shqiptarit,  
Ta shkelë, ta marrë më këmbë vëllanë!



*“Populli shqiptar ka disa veti shumë të mira... Por një bandë maskarenjsh, ryshfetçinjsh, hafijesh dhe dallaveraxhinjsh kanë zënë të gjitha pozitat kyçe në politikën e vendit dhe është fare e pamundur t’i shkulësh!”*

***Faik Konica, 1922***

# Këngë për qentë e Beogradit dhe bishtalecat shqiptarë

*(Këngë të moçme për Rrahman Morinqin,  
Sinan Hasanagiçin, Sllobodan Millosheviçin  
dhe Arkan Banditin! Për Sheshel Kllosharin dhe Serbinë  
e madhe, komandantin e mafies me spec, Madhërinë e  
Savës së Shenjtë dhe “vëllezërit” tanë bishtalecë!)*

Për Sheshel Sllokarin dhe Serbinë e madhe,  
dhe Savës së Shenjtë, komandantin Siliq të  
mafies, Madhërinë e Savës së Shenjtë dhe  
“vëllezërit” shqiptarë bishtalecë.

O shiftarë, lavdi serbe,  
Ithtarë të Drazha Mihajlit,  
Të madhërisë së Savës së Shenjtë, adhurtarë,  
Të Sllobo Manjakut përuhtarë.

O shiftarë, komshinj të Beogradit,  
Emrat prej serbëve u vijnë,  
Dhe pëlqeni Sllobo-lirinë.

Turqit ju turqizuan,  
Nga Dardan në Sinan,  
Nga Dritan në Rrahman,  
Nga Buletin në Hysamedin,  
Nga Ilirian në Ali Mysliman.



Byrazerët serbë të serbizuan,  
Në Simon Maniq,  
Në Rakiq Maniq,  
Në Zivçiq Usamliq,  
Në Ilija Sukurçiq.

Bukur fort sa më s'ka,  
Serbët e Slobodot i kënaq.

U bëtë lavdi serbe,  
Ua dimë se tanët jeni,  
Të dashur shiftarë qeni.

Jeni bij arnautësh,  
Faleminderit shumë.  
Shenjti Sava seç ju mbron,  
Bishtalecë qensh të Beogradit.

S'vini re, o kokëderra,  
Qen Beogradi ju vjen era.  
Kokëfuçi, pas i shkoni,  
Zgjyrës serbe me kobure.

Kjo qe Akademia e Shkencave,  
E serbit, e Çubrilloviçit,  
Kjo qe teoria çetnike e shkrimit,  
Me metodat raciste të spastrimit.

O shiftarë të jeniçerëve serbë,  
Shfarosni shqiptarët në Kosovë,  
Se shiftarët na u shtuakan,  
Serbët në Kosovë na kërcënuakan.

Nisni luftën në Fushë-Kosovë,  
Sllobo-Slloboda aty e lë vrapin,  
Të bëjë luftë, të bëjë namin,  
Shiftarët t'i therë e t'i helmojë,  
Të vriten ç'janë minatorë,  
Të burgosen me gjithë drejtorë.

O shiftarë me din e iman,  
Vëllezër si ne u bëtë  
Me serbët kristianë.  
S'u vjen keq për shiftarët tuaj,  
U bëtë qenër për një të huaj.

Ç'u bë besa ndër shqiptarë,  
E mbajnë peng serbët zagarë.  
Me besë do t'u varin,  
Të qajnë nënat për litarin.  
“Vëllezërve” çfarë u ndodhi:  
Me nderime në Kalemejdani,  
Me lot krokodili varrosur i kanë.

O shiftarë, vëllezërit tanë,  
Sllobo çetniku ju ka xhan,  
Zoti serb, i shenjti Sava,  
Ju fal mëkatet pa dava.  
U shkon shpirti lart në qiell,  
I pret Rankoviç çetniku,  
Shiftarët që koka u iku.

O shiftarë, dhëndurë serbi,  
Slloboja juaj lule qelbi.  
Gjithë shqiptarët ju mallkojnë.  
Ç'është sot ky pushtim,  
I shqiptarëve në Kosovë,  
Larë me gjak Malin e Zi,  
Eh, njësoj në Maqedoni.

Ja, është toka “vëllazërim-bashkim”,  
Ja, e Sllobo-Sllobodës shoviniist çetnik.  
Ja, është shekulli njëzet e një,  
Ja, e madhja çetnike Serbi,  
Shtyp shqiptarët në Kosovë,  
Po i vret, dëbon e tret.

Për shqiptarët, e re nuk qenka  
Teoria çetnike e praktika.  
Vrasin shqiptarë, boshnjakë e kroatë,  
Sllovenë e popuj të ngratë,  
Serbi të madhe të bëjnë në jetë e n’kartë.

Mos u trembni “vëllezër” shiftarë,  
Në Kosovë vijnë çetnikë gjeneralë,  
Me Millosheviç Sllobodanë,  
Me Sheshel Slokar e mafioz Arkanë,  
Me banditë komandarë.  
Mafia serbe e gjallë!...

Armata e mafies beogradase,  
Shqiptarët t’i shkulë e t’i vrasë.  
Me mafiozët ca shiftarë,  
Kërcënojnë vëllezërit shqiptarë.

O shiftarë, korba të zinj,  
Shiftarëve tuaj si t'u bini,  
Posi korbat i përpini.  
Mos shpresoni, s' do ketë shqiptarë,  
T'i harrojnë korbat tradhtarë.

O shiftarë, dhëndurë serbi,  
Nëna shqiptare ju mallkon.  
More burra, çka po ndodh,  
Mafia serbe vret e pret,  
Shtatë mijë fëmijëve helm u qet.

Mori nëna, çka po ndodh,  
Siliq banditi helmon kapedanin.  
Qenka ky “qytetërim” serb,  
Demonstruesit me mitraloz i vret.

Vëllezër e motra nëpër burgje,  
Tradhtarët serbëve u bëjnë sogje.

Nëpër burgje Adem Demaçi,  
28 vjet thërret pa pushuar:  
“Mos u jepni, vëllezër shqiptarë,  
Kosova e shqiptarëve e pandarë,

Pushkët gati sa më parë,  
Do qërohen nga Kosova,  
Qentë e serbit me tradhtarë.

Simon Rakiç e Usamljeniç,  
Me bishtecët shqiptarë,  
Hedhin valle serbe mbarë.  
Luajeni shifrarë vallen e zezë,  
Sllobo në Kosovë lirinë do presë.

Sheh ky Sllobo rreth e rrotull,  
Ti shifrar nga dheu i shqiptonjës luan.  
Luan serbja fizarmonikë,  
Trurin ua shpëlan.

Sllobo liria dhe e madhe Serbia,  
Shtyp shqiptarët në Kosovë e Maqedoni.  
Bosnjë, Kroaci e Slloveni,  
Aleatë faqezinj me Serbinë.

Maqedonia u ktheu shpinën,  
Flamur greku na e shpikën.

Fluturojnë shqiponja nëpër log,  
Malit të Sharrit e në Pollog.  
Për shqiptarin paqe s'ka,  
Me Maqedoninë në luftë ka ra.

Sllobo, Arkan e Sheshel,  
Shenji Sava e Serbi e madhe po u del.

Thërret Shesheli bythecë e katilë:  
Nga Beogradi para në Kosovë,  
Nga Kosova në Tiranë,  
Nga Tirana në Selanik,  
Nga Selaniku deri n'Athinë,  
Sa më t'madhe ta bëjmë Serbinë!

Slloboja më nuk po zë vend,  
Sllovenia, Bosnjë e Kroacia,  
Ia kanë dredhur me gjithë mend.

As boshnjakët s'kanë më paqe:  
Bosnjën tonë e duam pa çetnikë.

I thërret shqiptari boshnjakut:  
“Çohu i shkretë, hapi sytë së paku,  
Gjyshin e nënën tënde pyeti,  
Të tregojnë se si çetnikët  
Të kanë therë e të kanë mbyt”.

Izetbegoviçi na qenka nis’,  
Në Kosovë e Maqedoni,  
Gjithë shqiptarët që t’i lusë,  
Me atë serbin paqe të qëndisë.

Vjen Raif Dizdareviçi në Suedi,  
Kërcënon se në Jugosllavi,  
Shqiptarët i pret burgu i zi.

Asqeri serb me tanke në Kosovë,  
Shqiptarë të vrasë e të burgosë.

Emigrantët i bien telefonit,  
Ambasadës jugosllave në Stokholm:  
- Lutemi Dizdareviçit dy fjalë t’i themi.  
Kush je ti, armik i vëllazërim-bashkimit,  
Që s’paska kohë të flasë me emigrantët.



Mendon për të shkretët në Bosnjën e vet,  
Serbët e paskan shkelur me zjarr e hekur.

Ambasada veç kërcënon me burg,  
Emigranti shkurt ia këput:  
- Ngadalë, “vëlla”, mos na u ngut,  
Jugosllavia tash ka marrë fund.

Ç’kërcënon shqiptarët, o Dizdareviç,  
Bosnjën tënde serbi ta pushtoi,  
Bosnja jote thuajse vdiq.

Bosnja ime e të shkretët,  
Lufta juaj partizane aq me lavde,  
Vetëm serbit i erdh për mbarë.

Tash çetnikët të përshëndesin,  
Se të erdhën komshinj të parë,  
Bosnjën ta pushtojnë mbarë,  
Shtatë mijë njerëz për një natë të vrarë.

Ruaju, Dizdareviç i shkretë,  
Nga mafia serbe e vërtetë,  
Bosnja jote në gjak do zhytet.

Mali i Zi ka qenë i zi,  
Me Serbinë përherë në miqësi,  
Na u bë serb, numri dy mbretëri,  
Kosovë e Vojvodinë  
I pushtoi, i vu nën zgjedhë.

Pse po heshtni, zotërinj maxharë,  
Fis me mbretërinë tonë shqiptare.  
Vojvodina është hungare,  
Serbi s'ka kurrë hise, fare.

Nuk ka paqe për shqiptarë,  
Plot Serbia me çetnikë,  
që pushton e ther me thikë.

Moj Europë e qytetëruar,  
Që dëgjon e nuk bën zë,  
Kjo Kosova e Ballkanit,  
Na u bë Serbi e madhe.

Nuk ka paqe për Ballkanin,  
Luftë të madhe kanë menduar,  
Në Bosnjë e Kosovë,  
Çetnikët e mallkuar.

Shqiptarët qenkan tolerantë,  
Presin ditën në mejdan,  
Slllobodanin komandant.

Në Fushë-Kosovë shpatën po tregon,  
Millosh Kopilin prej varri po e çon.  
Kokë e Milloshit nuk u gjetka,  
Varri në tokë të shqipeve mbetka!  
Shqiptarët me bozhure të Kosovës  
Dhe me lule vese të çetnikut,  
Millosheviçin e kanë mbuluar,  
Nga shpirti i Virusit çetnik,  
Për jetë të jetëve kanë shpëtuar.

*Nga “Ditari” i Mërgim Vardarit  
Suedi, maj 1990*

*Sadulla Zendeli - Daja*



## Kambanë alarmi për lirinë dhe demokracinë

Ngjarjet e 27 prillit të këtij viti në Kuvendin e Maqedonisë kanë marrë dhenë dhe janë njohur në të gjithë botën si një atentat kundër vlerave të lirisë dhe të demokracisë, por edhe si veprime të dhunshme dhe vandale kundër liridashësve dhe demokratëve të vërtetë. Është kjo një çështje e nxehtë që ka pushtuar faqet e shtypit, ekranet e televizorëve, faqet rrjeteve sociale, gjithë botën mediatike. Gjithçka ndodhi atë ditë të 27 prillit 2017, falë mjeteve informuese, u identifikua saktë, me zë dhe me figurë. U bë qartësisht i njohur sulmi kundër parlamentit dhe përfaqësuesve të tij të ligjshëm e, veçanërisht, goditja e egër dhe barbare e figurës emblematike shqiptare, dr. Ziadin Selës.

Kam fatin ta njoh edhe personalisht dr. Ziadin Selën, vlerat e tij si shqiptar i madh, si lider dhe përfaqësues i denjë i virtyteve më të mira shqiptare. Gjithnjë luftëtar, gjithnjë i pamposhtur strugani Ziadin Sela ka punuar e luftuar pa u tërhequr, për të kërkuar ato të drejta të ligjshme që u takojnë shqiptarëve të Maqedonisë, ndërkohë që ka manifestuar vazhdimisht nivel dhe kulturë të lartë për historinë dhe ligjet e së drejtës ndërkombëtare. Janë lapidare thëniet e tij: *“Mund të më mundin, por s’mund të më thyejnë”*, *“Të bashkuar dhe vetëm të bashkuar jemi të pamposhtur”*, *“Mua mund*



*Ziadin Sela  
pritet triumfa-  
lisht nga  
banorët e  
Strugës.  
Maqedoni,  
maj 2017.*

*edhe të më vrasësh, por gjuhën dhe kombin shqiptar nuk mund ta vrasin kurrë!”.*

Kurse si një mjek dhe njeri i shquar, ai është përpjekur dhe përpiqet të shërojë me aftësitë e tij profesionale dhe shpirtërore plagët e rënda të shkaktuara shqiptarëve në shekuj, por dhe aktualisht në Maqedoninë e sotme.

Kam punuar për 27 vjet mësues i gjuhës shqipe në Nybro të Suedisë, ku pata fatin dhe rastin të luftoj për të hapur atje dhe në dy qytetet të tjera suedeze, në Kalmar dhe Emmaboda, shkollat shqipe. Mes atyre mërgimtarëve që më mbështetën aktivisht, ishin dhe bashkëkombësit e mi nga Struga, Ohri, Gostivari, Kërcova, Tetova, Shkupi. Ata e dinin rëndësinë e arsimit shqip, nevojën dhe domosdoshmërinë që fëmijët e tyre të arsimoheshin në gjuhën amtare, në gjuhën e bukur dhe të lashtë të të parëve tanë, prandaj dhe më përkrahën dhe mbështetën me të gjitha mënyrat dhe format, duke bërë bashkërisht që autoritetet suedeze të asaj kohe(1966) të vendosnin në shkolla edhe gjuhën amtare shqipe për fëmijët e

mërgimtarëve shqiptarë. Ishte kjo një dëshirë dhe vullnet i trashëguar nga të parët tanë, një dashuri e thellë për gjuhën tonë të bukur dhe unike shqipe, një arritje e rëndësishme arsimore, kulturore e kombëtare mbi serbët, të cilët, si ta kishin domen të tyre, donin të mbanin nën kthetrat e tyre mërgatën shqiptare në këto vise.

Sot shkollat shqipe vazhdojnë në të gjithë Suedinë dhe Skandinavinë. Ata nxënës, që atëherë ishin fëmijë, dhe që unë, si dhe shumë të tjerë, pata rastin t'u mësoj abc-në e Naimit, Kristoforidhit, Veqilharxhit, sot janë intelektualë dhe specialistë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë suedeze, por edhe mësues të gjuhës shqipe, që si në një stafetë zjarrpashuar, u mësojnë brezave gjuhën tonë.

Teksa i shoh këto, realisht në një vend me ekonomi shumë të zhvilluar dhe me demokraci të përparuar si Suedia, ku unë jetoj prej 52 vjetësh, ndiej ngazëllim për këtë dëshirë dhe vullnet shqiptar të përmbushur, jo më si ëndërr. Atje kisha për kredo timen: “Më mirë një punë e kryer, sesa njëqind e në mendje”. Punëkryerja i shpie gjërat shumë herë më përpara, sesa ëndërritjet me “sikurse”, që kolovisin shpeshherë shpresa të kota, gjallojnë vesin e jo virtytin!...

Duke jetuar dhe vetë deri në moshën 30-vjeçare në Gostivar, kam ndier dhe kam parë nga afër qëndrimin diskriminues të shtetit maqedonas, kam parë metodat çnjerëzore dhe luftën që ata kanë bërë dhe bëjnë kundër idealeve dhe simboleve kombëtare shqiptare.

Kam lexuar në libra, kam dëgjuar nga prindërit, por edhe kam përjetuar që në moshë të vogël barbaritë e ekstremiteteve maqedonase dhe të serbomëdhenjve kundër shqiptarëve dhe kjo me qëllimin e vetëm të uzurpimit të tokës së shenjtë shqipe, që ata e shkelën dhunshëm në shekujt VI-VII. Ndërkaq, duke abuzuar me shpirtmadhësinë dhe mikpritjen e shqiptarëve që i kanë strehuar dhe mirëpritur në trojet dhe vatrat e veta të lashta, ata kanë bërë ç'është e mundur kundër shqiptarëve, kundër lirisë së shenjtë dhe mendimit të përparuar demokratik shqiptar, kundër flamurit shqiptar me shqipen dykrenore. E teksa kujtoj përpjekjet shqiptare të gjithhershme për mbrojtjen e gjuhës sonë të bukur shqipe, shoh sesa luftë dhe përpjekje u duhen vëllezërve të mi shqiptarë aktualisht në Maqedoni për ta afirmuar gjuhën shqipe edhe si gjuhë zyrtare, kur kjo është një pikë e rëndësishme e Marrëveshjes së Ohrit të mbajtur që në vitin 2001 dhe e pazbatuar kryeneçërisht nga maqedonasit.

Dhuna që shpërtheu kundër parlamentit më 27 prill 2017 ishte pikërisht rrjedhojë e kësaj urrejtje kundër popullit dhe vlerave shqiptare, ishte një vendim i kahershëm kundër ekzistencës dhe qenies së shqiptarëve në drejtimin e vendit, në qeveri dhe në organe të tjera drejtuese e ligjvënëse. Me aktin barbar kundër dr. Ziadin Selës dhe liderëve të tjerë demokratë, ekstremistët serbo-maqedonas treguan se nuk tërhiqen lehtë nga rruga e tyre e gjakderdhjes dhe mohimit të të drejtave shqiptare. Duke parë atë veprim vandal dhe



*Nxënës të shkollës  
suedeze në qytetin  
Nybro të Suedisë,  
ku Sadulla Zendeli  
- Daja u ka dhënë  
mësim gjuhën  
shqipe në vitin  
1975.*

të turpshëm, të dhunshëm kundër parlamentit, bota ka rastin, si dhe herë të tjera të mbajë qëndrime të drejta në vlerësimin e ngjarjeve, të dallojë vlerat shqiptare kundrejt terrorit dhe shovinizmit, megalomanisë dhe harbutërisë okupuese. Kështu, njerëzit, kudo në botë, kanë përpara një pasqyrë të së mirës dhe së keqes, kanë rastin të njohin edhe më mirë, më realisht dhe objektivisht historinë dhe kulturën e lashtë të popullit dhe kombit shqiptar. Bota dhe Europa kanë rastin të sjellin në kujtesën e tyre Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotin Skënderbeun që, veçse u dha lirinë shqiptarëve për 25 vjet me radhë, u bë edhe një mur i pakapërcyeshëm për hordhitë e panumërta osmane që synonin pushtimin e Europës. Ndërkaq është madhështor emri dhe fama e Nënë Terezës, e cila është një shenjtore dhe simbol i madh botëror i paqes dhe vëllazërimit mes popujve të botës.

Për të ruajtur lirinë dhe pavarësinë, shqiptarët nuk kanë pranuar t'i përgjigjen asnjëherë agresorëve dhe pushtuesve, por kanë ngritur përballë tyre murin e hekurt



të qëndresës, rezistencës dhe luftës së vazhdueshme, duke përballuar kështu stuhitë e egra të kohëve, sulmet e pandërprera të hordhive të panumërta barbare, të cilat kanë dashur ta mbajnë kombin shqiptar të nënshtruar, ta asimilojnë atë, t'i shuajnë gjuhën, kulturën, traditat e çmuara e të vyera, që janë dhe do të jenë kurdoherë të palëkundura sepse mbështeten në rrënjën e thellë të tokës së lashtë pellazge-ilire-shqiptare.

Është e drejtë lufta dhe përpjekjet shqiptare për të ruajtur të pacenuar identitetin kombëtar, për të fituar të drejtat dhe liritë që u takojnë mbi bazën e ligjeve universale ndërkombëtare, por edhe atyre që rrjedhin nga “Marrëveshja e Ohrit” e nënshkruar në gusht të vitit 2001 nga maqedonas dhe shqiptarë, një marrëveshje kjo e njohur edhe ndërkombëtarisht.

Me të drejtë e kanë dënuar dhe demaskuar dhunën kundër parlamentit maqedonas dhe Ziadin Selës mijëra e mijëra njerëz nga e gjithë bota, njerëz të kategorive të ndryshme dhe nga shtete të ndryshme të botës, mes tyre njerëz të thjeshtë e deri akademikë, nxënës e mësues, kongresmenë dhe senatorë, deputetë dhe të zgjedhur, liderë politikë botërorë. Është aty edhe e gjithë mërgata shqiptare që, me zërin e saj të fuqishëm, i bënë botës një apel që ta shikonte me realizëm çështjen shqiptare dhe të mos u jepte të drejtë vetëm të mëdhenjve dhe të fuqishmëve. Duke mbështetur liderin demokrat shqiptar Ziadin Selën dhe krah për krah me të edhe Talat Xhaferin, i cili është shqiptari i parë që është zgjedhur kryetar i Parlamentit të Maqedonisë, ashtu dhe shumë

liderë të tjerë dhe demokratë të shquar liridashës, bota ka një arsye më shumë për të mbështetur më tej kauzën shqiptare, duke detyruar palën maqedonase të pranojë dhe të zbatojë atë që ka vendosur vetë në vitin 2001 me Marrëveshjen e Ohrit.



*Vajza të shkollës  
“Demokracia”  
të qytetit të Durrësit  
duke qëndisur flamurin  
kombëtar,  
më 28 Nëntor 2012.*

Kam lexuar se edhe Shoqata Kulturore Shqiptare “Ilirida” në Nybro të Suedisë, u ka dalë publikisht në mbrojtje të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, u ka dalë si përherë në mbrojtje vlerave të lirisë dhe demokracisë, por edhe luftëtarit të shquar Ziadin Sela, që sot është shpallur nga bota e qytetëruar përfaqësues dinjitoz i atdhetarizmit, i cili me qëndrimin dhe luftën e tij të vendosur është bërë simbol i rezistencës për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni. Sikurse, si çdo qytetar shqiptar, ndihem i emocionuar kur shoh se janë me mijëra njerëz, shqiptarë dhe të kombësive të tjera, në Maqedoni dhe në botë, të cilët shprehin nderim për heroin e lirisë dhe të demokracisë shqiptare Ziadin Sela, si dhe kundërshtojnë dhunën e përdorur kundër tij dhe parlamentit maqedonas.